



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.477/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Skender Cocaj dhe Arsim Hamzaj- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kallxo.com me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 11.02.2025, mori këtë:

#### V E N D I M

REFUZOHET e pabazuara ankesat Anr.477/2025 datë 07.02.2025, parashtruar nga Kallxo.com me seli në Prishtinë, kundër subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli Komuna Prishtinë.

#### A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga organizata BIRN-Interneës Kosova, Kallxo.com, me të cilën pretendohet se më datë 07.02.2025 redaksia e KALLXO.com, si prodhuese e emisionit zgjedhor "Debat Përnime 2025", ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje e Cila është protokolluar në PZAP me numrin e protokollit 344. Në vazhdim të ankesës theksojnë se ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje është ndërtuar mbi pretendime të pavërteta dhe shpifëse ku synon të bëjë presion të padrejtë tek ekipi i KALLXO.com për të ndaluar raportimet për informacionet e sakta të cilat lidhen me korrupsionin, meritokracinë dhe punësimet politike. Më tutje theksohet se ankesa e LVV pretendon pa asnjë bazë se emisioni Debat Pernime ka qëllime "Politike" të cilat në asnjë rrethanë nuk janë të vërteta dhe paraqesin një fyerje të rëndë për gazetarinë hulumtuese dhe verifikuesit e fakteve. Parashtruesi i ankesës thekson se duke dorëzuar një ankesë të pa bazë dhe të pathemeltë, LVV synon të pengojë seriozisht punën e tyre profesionale në raportimin e informacioneve të sakta për publikun të cilat vijnë si rezultat i punës së tyre hulumtuese në 20 vite.

Parashtruesi i ankesës pretendon se me veprimet e saja, përpos që ka shkelur pikën 1.5 të nenit 34, ka shkelur edhe pikën 1.10 të nenit 34 të ligjit për zgjedhjet. Hartimi i një ankese të pabazuar, e cila botërisht dihet që nuk ka asnjë mbështetje, paraqet abuzim me të drejtën e ankesës e cila në themelet e saj ka paraqitje të rrejshme të fakteve dhe nuk ka asnjë vlerë.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 10.02.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kanë theksuar se me shkresën 344/3 e datës 05.02.2025 nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia jemi njoftuar se ky organ nuk është kompetent për shqyrtimin e ankesave të cilat pretendojnë shkelje të ndodhura në medime, në bazë të neni 51.2 të LZP-së. Më tutje theksojnë se ankesa e tyre me nr.344/25 nuk ka marrë trajtim në merita nga ana e PZAP, pikërisht për shkak se ky organ në bazë të Legjislacionit në fuqi ka konsideruar se nuk janë kompetent për trajtimin e çështjes. Lidhur me këtë theksojnë se nuk mund të krijoj një ngjarje ku ata si subjekt keqpërdorim të drejtën e tyre për paraqitje të ankesës, deri sa një ankesë e tillë pranë PZAP nuk ekziston pasi që e njëjta i është referuar KPM-së, ndërsa norma të cilën ankuesi referohet i përket Ligjit (LEX SPECIES) i cili vlen vetëm për ankesat që drejtohen në PZAP dhe jo ankesa që nuk bien në domenin e këtij organi shtetëror. Më tutje në përgjigje theksojnë se kjo normë nuk mund të i mëveshët kësaj ngjarje për arsye se kjo ngjarje nuk ka ndodhur asnjëherë siç theksohet, PRA ASNJËHERË NUK KEMI KEQPËRDORUR TË DREJTËN TONË SEPSE ASNJËHERË KJO ANKESË NUK ËSHTË PROCEDUAR.

Duke u bazuar në të lartcekurat e kësaj përgjigje në ankesë dhe pretendimet e palës ankuese kërkojmë nga PZAP që ankesën Anr.477/2025 të parashtruar nga Kallzo.com, të refuzohet si e pabazuar

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankesa e Kallxo.com i referohet shkeljeve me referencë në ankesën e protokolluar në PZAP me numrin Anr.344/2025, e pranuar në PZAP më datë 03.02.2025 e Lëvizjes Vetëvendosje, kundër Kallxo.Com. PZAP ankesën e tillë e ka dërguar në vendosje në KPM, bazuar në nenin 51.1 dhe 2 të LZP-së, që përcakton se: *“...shkeljet nga mediat parashtrohen në Komisionin e Pavarur për Media (KPM) në pajtim me dispozitat e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave. Të gjitha ankesat të cilat pretendojnë në shkeljen e këtij kapitulli përcillen nga PZAP-i, për rishqyrtim dhe vendosje nga KPM-ja”*.

PZAP vlerëson se është i paqëndrueshëm pretendimi i Kallxo.com për shkelje të nenit 34, par.1.5 të LZP, që përcakton se: *“ Pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale”* kjo pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar që subjekti politikë Lëvizja Vetëvendosje të ketë marrë ndonjë veprim për të penguar apo tentuar për të penguar gazetarët e Kallxo.com. Fakti që ky subjekt politikë ka paraqitur ankesë në PZAP kundër këtij mediumi, për shkeljet e pretenduara në ankesë, kjo në asnjë rrethanë nuk konsiderohet si pengim apo tentim pengimi të gazetarëve. Madje ankesa e subjektit politikë VV nga PZAP është përcjelle në vendosje në KPM, si organ kompetent për të vendosur në raste të tilla, ashtu siç është përcaktuar me nenin 51.2 të LZP-së, ku është parapa se: *“Të gjitha ankesat të cilat pretendojnë në shkeljen e këtij kapitulli përcillen nga PZAP-i, për rishqyrtim dhe vendosje nga KPM-ja”*.

Përveç kësaj, nuk mund të konsiderohet se subjekti politik në fjalë të këtë bërë edhe shkelje nga neni 34, par.1.10 të LZP, që ka përcaktuar se: *“ Abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP”*, kjo pasi që nuk mund të konsiderohet abuzim me të drejtën e ankesës kur pala ngrit pretendime ankimore për një çështje, ndërsa për këtë ankesë ende nuk është vendosur nga KPM-ja si organ kompetent për raste të tilla.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës si dhe nga hetimi i ndërmarr ngPZAP-ja, nuk ka të bëjë me veprimet që paraqesin shkelje të dispozitave nenit 34, paragrafi 1.5 dhe 1.10 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), *“pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale dhe “abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP”*

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A.nr. 477/2025 më datë 11.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vend